

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.Sh., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.11 të KPK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, si dhe të akuzuarit E.Sh.2 nga Prizreni, për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.11 të KPK-së, duke vendosur përkritazi me ankesën e Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren, të dëmtuarve, Z.D., A.Th. dhe M.E., si dhe mbrojtësve të akuzuarve, av. M.H. dhe av. B.Sh. dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit E.Sh.2, av. B.Sh., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, P.nr.11/2016, të datës 02.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur në pajtim me dispozitën e nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 06.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pa bazuara ankesat e Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren, të dëmtuarve dhe mbrojtësit të akuzuarit E.Sh., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, P.nr.11/2016, të dt. 02.10.2017, përkritazi me të akuzuarin E.Sh., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së vërtetohet.

Me pranimin e ankesave të Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren, dhe mbrojtësve të akuzuarve E.Sh. dhe E.Sh.2, por edhe sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.11/2016, të datës 02.10.2017, përkritazi me veprat penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën par.11 të KPK-së, dhe veprës penale dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 lidhur par.2 nën par 2.1 të KPK-së, anulohet dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendim.

Ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren, të dëmtuarve, përkitazi me vendimin për dënim, tani për tani mbesin jo lëndore.

Aktgjykimi i ankimuar përkitazi me pjesën refuzuese për të akuzuarin E.Sh.2 mbetet i paprekur.

Të akuzuarit E.Sh., i vazhdohet paraburgimi.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, me aktgjykimin P.nr.11/2016, të datës 02.10.2017, të akuzuarin E.Sh., e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.11 të KPK-së, si dhe për veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, ndërsa të akuzuarin E.Sh.2, e ka shpallur fajtor për vepër penale dhënia e ndihmës pas kryerjes të veprës penale nga neni 388 par.1 lidhur par.2 nën par.1 të KPK-së, dhe për këto vepra penale, pasi më parë i ka përcaktuar të akuzuarit E.Sh., për veprën e parë penale, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 23 (njëzet e tre) vjet, dhe për veprën e dytë penale dënimin me burgim prej 2 (dy) vjet, e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 24 (njëzet e katër) vjet, ndërsa të akuzuarin E.Sh.2, e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjet e 6 (gjashtë) muaj, dënime këto në të cilat ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 10.03.2015, e tutje për të akuzuarin E.Sh., ndërsa, për të akuzuarin E.Sh.2, nga data 13.03.2015 e gjerë më datën 02.09.2017. Të akuzuarit i ka obliguar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor, secili veç e veç shumën prej nga 400 (katër qind) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit M.E., Z.D. dhe A.Th., për realizimin e kërkesës pasurore–juridike i ka udhëzuar në kontest civil.

Të akuzuarit E.Sh., i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues-konfiskimin e armës të automatike të tipit “Kallashnikov”, si dhe pistoletën “Cërvena Zastava” M-70, me nr.C-813100, si mjete të kryerjes së veprës penale.

Me aktgjykimin e njëjtë, për të akuzuarin E.Sh.2, bazuar në dispozitat e nenit 363 par.1 nën par. 1 është refuzuar akuza për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së pasi që në seancën e shqyrtimit gjyqësor prokuroria ka hequr dorë nga ndjekja e mëtutjeshme për këtë vepër penale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së Ligjit Penal, përkitazi me të akuzuarin E.Sh.2, ndërsa, përkitazi me të akuzuarin E.Sh., vetëm për vendimin mbi dënimi, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, përkitazi me të akuzuarin E.Sh.2, ndërsa, përkitazi me të akuzuarin E.Sh., vetëm të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, ashtu që të akuzuarit E.Sh., t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim.

Përfaqësuesja e palës së dëmtuar, Z.D., av. E.Sh.-M., për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim ose të ndryshohet dhe të akuzuarve, t'iu shqiptohen dënime më të ashpra me burgim.

E dëmtuara A.Th., për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime më të ashpra me burgim.

I dëmtuari, M.E., për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim ose të ndryshohet dhe të akuzuarve, t'iu shqiptohen dënime më të ashpra me burgim.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.Sh., av.M.H., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që për të akuzuarin E.Sh., ta bëjë ricilësimin e veprës penale nga vrasje e rëndë në vepër penale të vrasjes në gjendje të tronditjes së fortë mendore dhe pastaj t'i shqiptohet dënim sa më i butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.Sh.2, av. B.Sh., për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që i akuzuari për vepër penale për të cilën është shpallur fajtor të lirohet nga akuza e prokurorisë.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë, ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit E.Sh.2 av. B.Sh., me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa, përkitazi me aktgjykimin e ankimuar të veprohet sipas propozimit në ankesë të paraqitur kundër aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e mbajti konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën i ka njoftuar me rregull Prokurorin e Apelit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre. Në seancën e kolegjit ishin prezent të dëmtuarit Z.D., M.E. dhe A.Th., përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. E.Sh.-M.u, mbrojtësja e viktimave Ganimete Kitmeri, i akuzuari E.Sh., mbrojtësit e të akuzuarve av. M.H. dhe av. B.Sh., ndërsa edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantuan Prokurori i Apelit, dhe i akuzuari E.Sh.2. Në seancën e kolegjit përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës, mbrojtësja e viktimave si dhe vetë të dëmtuarit, pasi më parë sqaruan disa nga pretendimet ankimore ngelën në tërësi pranë pretendimeve si në ankesë. Mbrojtësi i të akuzuarit E.Sh., av. M.H., po ashtu, pasi më parë

sqaroi disa nga pretendimet ankimore, propozoi gjykatës që për shkak të arsyrave të cekura si në ankesë ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe për të akuzuarin E.Sh. ta bëjë ricilësimin e veprës penale dhe të njëjtit t'i shqiptojë dënim sa më të butë, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit E.Sh.2, av. B.Sh., deklaroi se pasi që i akuzuari është shpallur fajtor për vepër penale dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale, atëherë, duke u bazuar në par. 5 të nenit në fjalë i akuzuari E.Sh.2 duhet të lirohet nga akuza, pasi që të akuzuarin e parë e ka baba, pra për shkak të raporteve familjare, përjashtohet përgjegjësia penale për të akuzuarin E.Sh.2.

Prokuroria e Apelit, përmes parashtresës PPA/l.nr.61/18, të dt.12.02.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore dhe të dëmtuarve të aprovohen, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe të kthehet në rivendosje, përkitazi me të akuzuarin E.Sh.2, ndërsa, përkitazi me të akuzuarin E.Sh., të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit E.Sh.t, t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar konformë dispozitës së nenit 394 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesa dhe përgjigje të ankesës gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë, të dëmtuarve dhe e mbrojtësit të akuzuarit E.Sh., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, përkitazi me vendimin për dënim janë të pabazuara, ndërsa, ankesa e prokurorisë dhe mbrojtësve të akuzuarve për veprat tjera penale janë të bazuara, por duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i ankimuar për këtë pjesë duhet anuluar.

Pretendimet ankimore të palëve përkitazi me veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, për të akuzuarin E.Sh..

Me ankesat e paraqitura kundër aktgjykimit të ankimuar, aktgjykimi i shkallës së parë, përkitazi me të akuzuarin E.Sh., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal, megjithatë, Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt dhe atë konformë dispozitave të nenit 394 të KPPK dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar përkitazi me këtë pjesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, por as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit.

Po ashtu, përkitazi me këtë pjesë të aktgjykimit – pra, veprën penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, për të akuzuarin E.Sh., as gjendja faktike nuk ka qenë objekt i vlerësimit nga kjo gjykatë nga se i njëjti as në ankesë nuk ka mundur të ankimohet pasi që i akuzuari E.Sh., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës përkitazi me veprën penale në fjalë dhe po ashtu trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë-konformë dispozitave të nenit 383

par. 2 të KPPK, prandaj, aktgjykimin e ankimuar për këtë pjesë e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore përkitazi me vendimin për dënim për të akuzuarin E.Sh..

Duke e vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për sanksionin penal, për të akuzuarin E.Sh., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të prokurorisë, të dëmtuarve e as të mbrojtësit të akuzuarit E.Sh.. Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, përkitazi me këtë bazë ankimore—pra vendimi për dënim, nuk është thënë asgjë konkretisht përveç që është kundërshtuar vendimi për dënim, ndërsa në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, por edhe të dëmtuarve tjerë, theksohet se dënimi i shqiptuar është i butë, pra jo adekuat me pasojën e veprës penale por as përgjegjësive penale të akuzuarit, mirëpo, në arsyetim përkitazi me pretendimet në fjalë, flitet kryesisht për veprën penale të vrasjes, ndërsa, përkitazi me veprën penale të armë mbajtjes nuk theksohet asgjë konkretisht, sikur që të njëjtën gjë e ka bërë edhe mbrojtësi i të akuzuarit E.Sh., av. M.H., vetëm se, kuptohet, që ka propozuar që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit jo vetëm që drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e sanksionit penal, por të njëjtat njëkohësisht edhe i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë, sidomos, kur merr parasysh edhe llojin dhe sasinë e armëve – pra, është fjala për pushkë automatike AK-kalashnikov, pastaj, bëhet fjalë edhe për një revole tjetër të markës “Crvena Zastava”. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e cekura më lartë si dhe rrethanat e rastit konkret rezulton se dënimi i shqiptuar të akuzuarit, me aktgjykimin e ankimuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësive penale të akuzuarit dhe se në praninë e këtyre rrethanave nuk ka arsye që të akuzuarit të i shqiptohet dënim më i rëndë sikur që propozon prokuroria dhe të dëmtuarit, ose dënim më të butë, sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, kuptohet, përkitazi me veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në drejtim të veprave penale vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën par.11 të KPK-së, dhe dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 1 e lidhur me par. 2 nën par. 2 të KPK-së, dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore DKR në Prizren, përkitazi me këtë bazë ankimore, pretendon se aktgjykimi i ankimuar përkitazi me veprën penale dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 1 e lidhur me par. 2 nën par. 1 të KPK-së, pra, për të akuzuarin E.Sh.2, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 par. 12 të KPPK-së, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka bërë ricilësimin e veprës penale nga vepra penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.11 të KPK-së, në veprën penale dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 lidhur par. 2 nën par. 1 të KPK-së, për çka, së pari dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar përkitazi me këtë vepër penale bie në kundërshtim të drejtë për drejtë me arsyetimin, ndërsa, arsyetimin në kundërshtim me provat dhe shkresat tjera në lëndë, gjë që si

pasojë rezulton me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së. Gjithashtu, sipas pretendimeve ankimore, përshkrimi i veprimeve inkriminuese të akuzuarit E.Sh.2, në dispozitiv nuk gjen mbështetje në deklaratat e dëshmitarëve por as vetë të akuzuarit, e sidomos në provat materiale, si foto dokumentacionin, skicën e vendit të ngjarjes, pastaj, po ashtu, dispozitivi në fjalë është në kundërshtim edhe me CD-et në shkresat e lëndës, CD këto nga të cilat rezultojnë fakte dhe rrethana krejtësisht tjera nga ato që paraqiten në dispozitiv. Sipas pretendimeve ankimore, si rezultat i shkeljeve esenciale në fjalë edhe gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për çka gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal, kuptohet në favor të akuzuarit E.Sh.2, kur të njëjtën e shpall fajtor për vepër tjetër penale e jo për vepër penale që ka qenë i akuzuar me aktakuzë, duke bërë pra, kështu ricilësimin e veprës penale nga vepra penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën par.11 të KPK-së, në vepër penale dhënia e ndihmës pas kryerjes të veprës penale nga neni 388 par. 1 e lidhur me par. 2 nën par. 1 të KPK-së. Ndërsa, në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit E.Sh., av. M.H., edhe pse tek bazat ankimore nuk cekët shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, por vetëm shkelje e ligjit penal, nga arsyetimi i ankesës, rezulton se bëhet fjalë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së, ngase, me ankesën në fjalë pretendohet se i akuzuari E.Sh., është dashur të shpallet fajtor për vepër penale të vrasjes në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 180 të KPK-së, e jo për vrasje të rëndë, sikur që ka vepruar gjykata e shkallës së parë. Përkitazi me pretendimin në fjalë, në arsyetim të ankesës, pasi më parë paraqiten fakte dhe rrethana përkitazi me raportet e mëhershme të akuzuarit me tani të ndjerit F.Sh.,H.Th. dhe B.E., po ashtu, pretendohet se edhe ditën kritike pikërisht si rezultat i provokimeve dhe sjelljeve të tani të ndjerëve ka ardhur edhe te kryerja e veprës penale dhe atë sidomos kur të ndjerët në momentin kritik përveç që të akuzuarit ia tregojnë armën që posedonin, po ashtu, i janë drejtuar me fjalët “a don me tu zbut hala, a don me ta zbut djalin...” fjalë këto pra dhe provokime të cilat pastaj, së bashku edhe me sjelljet e mëparshme provokuese, ku edhe disa herë edhe e kanë rrahur të akuzuarin, e në rastin e parafundit të akuzuarit i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore, dhe të gjitha këto së bashku të akuzuarin e kanë sjellë në gjendje të tronditjes së rëndë mendore dhe si pasojë e frikës nga sulmi i të ndjerëve në të akuzuarin, i njëjti-pra, i akuzuari kthehet tek automjeti dhe nga bagazhi i saj nxjerrë pushkën automatike AK-47 dhe pastaj ka shtënë në tani të ndjerët, e që i njëjti – pra, duke vepruar në gjendje esencialisht të zvogëluar, kryen veprën penale në fjalë, por jo sikur që ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.11 të KPK-së. Prandaj, sipas mbrojtjes së të akuzuarit E.Sh., gjykata e shkallës së parë, nuk ka marrë parasysh faktet dhe rrethanat në fjalë, e që rezultojnë të vërtetuara nga provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e që të akuzuarin ta shpallë fajtor për vepër penale të vrasjes të kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 180 të KPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të cekura si më lartë, përkitazi me veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 11 të KPRK-së, dhe veprës penale dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 lidhur par.2 nën par 1 të KPK-së, janë të bazuara por duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare, rezulton se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara me dispozitën e nenit 384 par.1. nën par. 12 e lidhur me dispozitat e nenit 361 dhe 370 par. 7 të KPPK-së, ngase, dispozitivi

i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kontradiktor dhe kundërthënës me brendinë e tij, pastaj, arsyet e dhëna në aktgjykim, përveç që nuk kanë mbështetje në provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor të njëjtat po ashtu kanë kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit e lidhur me përmbajtjen e shkresave të çështjes, kundërthënie këto të cilat aktgjykimin e ankimuar e bëjnë jo të ligjshëm dhe si të tillë duhet anuluar.

Në këtë çështje penale juridike përveç që dispozitivi është në kundërshtim të drejtë për drejtë me arsyetimin edhe arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar për faktet vendimtare ka kontradikta të konsiderueshme mes asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit e me përmbajtjen e dokumenteve ose procesverbaleve dhe atë sidomos me deklaratat e të akuzuarve, të cilët kanë dhënë deklaratat diametralisht të kundërta e krejtësisht kontradiktore në mes asaj që paraqitet në dispozitiv e me përmbajtjen e deklaratave të përshkruara në arsyetim, pastaj, edhe me provat materiale në shkresa të lëndës e sidomos me CD-et, foto dokumentacionin skicën e vendit të ngjarjes por edhe shkresat tjera në lëndë, ndërsa, gjykata e shkallës së parë, pa marrë fare parasysh kontradiktat në fjalë, në arsyetim konstaton se në bazë të deklaratave në fjalë, por edhe provave materiale ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, gjë që, bie në kundërshtim të plotë, me provat në shkresat e lëndës.

Në bazë të përmbajtjes së dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar rezulton se i njëjti nuk ka mbështetje në arsyetim dhe atë duke përfshirë dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar për dy vepra penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtorë, kuptohet për secilin veç e veç, dhe atë së pari dispozitivi në fjalë përkitazi me veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 11 të KPRK-së, nuk ka mbështetje në arsyetim, gjegjësisht përveç, që është në kundërshtim me arsyetimin, i njëjti – pra, arsyetimi po ashtu, është në kundërshtim edhe me vetë brendinë e tij. Kështu, së pari dispozitivi për vepër penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 11 të KPRK-së, rezulton të mos ketë mbështetje në provat dhe shkresat tjera në lëndë, sidomos, kur konstatohet “... ashtu që kur janë ofruar vendit të ngjarjes, del nga automjeti dhe kur i vëren të ndjerët të cilët kishin qenë duke lëvizur në rrugë, shkon e hap bagazhin nga i cili merr pushkën gjysmë automatike dhe në një distancë shtënë në drejtim të tyre dhe që te tre nga breshëria e plumbave goditen të cilët më pas nga plagët e marra rrëzohen në tokë ku i njëjti iu ofrohet edhe me pistoletën të cilën e ka pasur në brez gjuan duke qëlluar për vdekje...” përmbajtje kjo e dispozitivit nga i cili rezulton se i akuzuari E.Sh. me të dalë nga automjeti, pa biseduar fare, pa qenë pra, i provokuar nga të ndjerët, ka filluar të qëllojë me armë dhe atë me pushkë automatike në drejtim të tyre dhe atë, pra, menjëherë me të vërejtur tre të ndjerë pra, pa biseduar fare, gjë që një konstatim i tillë në dispozitiv nuk përputhet me përmbajtjen e provave dhe shkresave të lëndës, gjegjësisht deklaratën e të akuzuarit E.Sh. të paraqitur në arsyetim, i cili deklaron krejt diçka tjetër e duke u arsyetuar se si pasojë e veprimeve provokuese të tre të ndjerëve edhe e ka kryer veprën penale të vrasjes – pra, nën ndikimin e afektit mendor, fakte dhe rrethana këto që nuk cekën në dispozitiv por që janë konstatuar në deklaratat e të akuzuarit, kuptohet në arsyetim kur është paraqitur përmbajtja e deklaratës së të akuzuarit E.Sh.. Të njëjtën gjë, gjykata e shkallës së parë, e ka bërë edhe përkitazi me dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar për të akuzuarin E.Sh.2, ngase, përkitazi me këtë të akuzuar – pra, E.Sh.2n, në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar konstatohet “.... duke krijuar kushte që baba i i tij, i akuzuari E.Sh., pas kryerjes së veprës penale të vrasjes së rëndë, ka ndikuar në krijimin e kushteve për fshehjen e provave, të kryerjes së veprës penale, ashtu që pistoletën me të cilën babai i tij ka kryer veprën penale e ka

fshehur e më pas me rastin e dorëzimit.....”, mirëpo, nga përmbajtja e provave të paraqitura në arsyetim dhe atë sidomos deklarata e dëshmitarit N.L., pastaj provave materiale; si CD-e, skicën e vendit të ngjarjes dhe foto dokumentacioni në shkresat e lëndës, rezultojnë faktet dhe rrethana krejt tjera nga ato që janë paraqitur në dispozitiv dhe atë sidomos fakte dhe rrethana që rezultojnë sidomos nga përmbajtja e CD-ve, foto dokumentacionit dhe provave tjera materiale, ku sidomos nga foto dokumentacioni por edhe CD-et, shihet në mënyrë të qartë se si i akuzuari E.Sh.2, del disa herë nga automjeti dhe futet përsëri dhe po ashtu, e ndihmon të akuzuarin tjetër duke ia hapur derën dhe të gjitha këto lëvizje i bënë me armë në dorë, pastaj, nga deklarata e dëshmitarëve N.L. dhe F.Th., rezultojnë faktet dhe rrethanat tjera që gjykata e shkallës së parë, nuk i ka marrë fare parasysh, fakte këto dhe rrethana të gjitha që kanë ndodhur pikërisht në momentin kur është kryer vepra penale e vrasjes, prandaj, sipas një konstatimi të tillë rezulton se dispozitivi nuk përputhet me përmbajtjen e provave në fjalë, gjë që dispozitivin e vë në kundërshtim të drejtë për drejtë me provat dhe shkresat tjera në lëndë, gjë që pretendohet edhe nga prokuroria, e që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së.

Shkelje tjetër esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe në arsyetim, ngase, ka dështuar të jap arsyeza për faktet vendimtare, dhe atë pa bërë në arsyetim më parë një analizë të mirëfilltë e objektive të gjitha provave, duke përfshirë këtu deklaratat e të akuzuarve, pastaj të dëshmitarëve si dhe provave materiale, pastaj, të mund të nxjerrë konkludime të drejta, qoftë për të akuzuarin e parë qoftë për të akuzuarin e dytë, ngase, në rastin konkret, pa bërë pra një gjë të tillë, por vetëm ka paraqitur përmbajtjen e deklaratave të akuzuarve, të dëshmitarëve dhe provave materiale, e duke konstatuar më pastaj se është vërtetuar gjendja faktike, kuptohet, duke konstatuar këtu gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, mirëpo, pa bërë analizën më parë, e pastaj, vlerësimin e të gjitha provave, kuptohet duke i krahasuar më parë njëri me tjetrin dhe në fund të jap konkludimet e saja përkitazi me veprën penale por edhe për përgjegjësinë penale të akuzuarve, për çka edhe rezulton se arsyerat për faktet vendimtare janë pa mbështetje në prova dhe shkresa tjera të lëndës, gjegjësisht në kundërshtim me përmbajtjen e provave dhe shkresave tjera në lëndë. Prandaj, arsyerat për faktet vendimtare, përveç që arsyetimin e bëjnë të paqartë, konfuz dhe kundërthënës, të njëjtin në rastin konkret e vejnë në kundërshtim edhe me vetë veten, ngase, për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 11 të KPK-së, derisa në faqen 12, pasusi 2 konstatohet “... i akuzuari E. e ka ftuar djalin e tij, këtu të akuzuarin E.2, që me automjet ta dërgon gjerë tek berberi për t'i shkurtuar flokët, ku rreth orës 14,00 min. kanë mbërri te lokali “Berberi” përballë gjimnazit, e E.i ka dalë nga automjeti Golf 2 dhe është ofruar afër derës së berberit për me pyet se a ka kohë me qeth dhe me rru dhe në momentin kur i akuzuari E. ka dashur me hy tek berberi, është zatetur me tre të ndjerët të cilët i kanë dalë përballë dhe i kanë thënë të akuzuarit E. “ a po duhesh me të rrah si të kemi rrahur më herët” dhe sipas tij, të ndjerët paskan ngritur duart në brez, ku i ka parë armën F.Sh..... dhe pas provokimit të tyre, i akuzuari E. është kthyer në automjet, në fillim ka shtënë me armë – pistoletë në drejtim të e pastaj, edhe me pushkë automatike, të cilën e ka marrë nga bagazhi....”, që do të thotë se sipas këtij konstatimi në arsyetim, rezulton se i akuzuari E.Sh., më parë ka biseduar me tani të ndjerët dhe pasi iu ka vërejtur edhe armë në brez, pra, pas edhe provokimeve të tyre, i akuzuari është kthyer në automjet dhe pastaj ka shtënë me armë dhe atë së pari me revole pastaj me pushkë automatike, ndërsa, po për faktet dhe rrethanat në fjalë, në faqen 22 pasusi 1 e 2 dhe në vazhdim të faqes 23,

pasusit 1, ku konstaton se ka vërtetuar gjendjen faktike, konstaton fakte dhe rrethana krejtësisht tjera, gjegjësisht, "... ashtu që kur i janë ofruar vendit të ngjarjes, del nga automjeti dhe kur i vëren të ndjerët të cilët kishin qenë duke lëvizur në rrugë, shkon e hap bagazhin nga i cili merr pushkën gjysmë automatike dhe në një distancë shtinë në drejtim të tyre dhe që te tre nga breshëria e plumbave goditen.... rrëzohen në tokë ku i njëjti iu ofrohet dhe me pistoletë të cilën e ka pasur në brez, gjuan duke i qëlluar për vdekje,", që do të thotë se tani tek vërtetimi i gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë, konstaton fakte dhe rrethana tjera nga ato që i ka deklaruar në pasusin e mëparshëm, gjë që, arsyetimin e bëjnë të paqartë, konfuz dhe të njëjtin e vejnë edhe në kundërshtim me vetë veten, e që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së. Pastaj, se aktgjykimi i ankimuar është konfuz dhe juridikisht i paqëndrueshëm qëndron edhe në faktin se pikërisht mungesa e fakteve dhe rrethanave që i deklaroi vetë i akuzuari, e që nuk i ka marrë parasysh tek dhënia e arsyerave për faktet vendimtare, pikërisht fakte dhe rrethana në fjalë, gjykata e shkallës së parë, i merr tani si arsye për të konstatuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me provokime të tre të ndjerëve, gjë që në arsyetim konstatohet në faqen 42 pasusi 3, duke konstatuar, "gjykata mori për bazë ... posaçërisht pretendimet se i akuzuari në momentin "tempore kriminis" veprroi në gjendje të efektit të rëndë mendor nga sjelljet e vazhdueshme provokative të tani të ndjerëve të shkaktuara pa fajin e tij, të cilat në momentin kritik ishin kulminante, kur te tret në grup iu drejtuar me fjalët " a don me të zbutë hala, apo don me ta zbutë djalin", kurse në ato çaste ai hup kontrollin dhe i frikësuar për të birin dhe vetë veten ai ndërmerr veprimin....", që do të thotë se tani pikërisht faktet dhe rrethanat në fjalë i merr si arsyetim për veprimin inkriminues të akuzuarit, pra, si shkaqe që e kanë shtyrë të akuzuarin të kryej veprën penale në fjalë, që do të thotë se arsyetimi tani bie ndesh, përveç drejtë për së drejti me përmbajtjen e provave në shkresat e lëndës edhe me vetë veten dhe atë mu tek dhënia e arsyerave për faktet vendimtare, ngase, edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit pretendohet se pikërisht faktet dhe rrethanat në fjalë, kanë qenë shkaqet që e kanë shtyrë të akuzuarin të kryejë vepër penale, e që edhe pretendon se këtë i akuzuari e ka bërë si pasojë e veprimeve provokuese të tre të ndjerëve, ndërsa, gjykata e shkallës së parë, përkitazi me pretendimet në fjalë jep krejt vlerësim tjetër, pra, për faktet dhe rrethanat e njëjta jep dy vlerësime të ndryshme, gjë që arsyetimin e bëjnë të pa qartë, konfuz, kundërthënës dhe juridikisht të paqëndrueshëm.

Po ashtu, kur jemi të dhënia e arsyerave për faktet vendimtare, qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye të qëndrueshme as për ekspertizë të psikiatrisë, ngase, në rastin konkret në bazë të shkresave në lëndë por edhe procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se përkitazi me aftësinë mendore të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, ka proceduar dy ekspertiza të psikiatrisë, e që njëra konstaton se i akuzuari ka vepruar nën ndikimin e përgjegjësisë esencialisht të zvogëluar, kurse tjetra ka konstatuar se i akuzuari ka qenë i aftë në aspektin mendor, që do të thotë se kemi të bëjmë me dy ekspertiza me mendime të ndryshme, ndërsa, gjykata e shkallës së parë, edhe përkundër kundërthënieve në fjalë në mes dy ekspertizave, pa dhënë arsye konkrete, vetëm konstaton në mënyrë të përgjithësuar se besimin ia ka falur ekspertizës së dytë, kurse, ekspertizën e parë e vlerëson si të pabazë dhe të paargumentuar, duke marrë kështu, tani, pra, gjykata edhe rolin e ekspertit në këtë çështje penale-juridike, arsye këto të gjitha së bashku që paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së, e që ndikuan domosdoshmërisht në anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Të njëjtat shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë, i ka bërë edhe gjatë dhënies së arsyrave për faktet vendimtare për të akuzuarin e dytë, gjegjësisht, për veprën penale dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 1 e lidhur me par. 2 nën par. 1 të KPK-së, ngase, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, nuk ka marrë fare parasysh përmbajtjen e CD-eve dhe foto dokumentacionit, ku haptazi vërehet se i akuzuari i dytë me armë në dorë lëviz disa herë pranë automjetit dhe atë duke hyrë dhe duke dalë nga automjeti, pastaj, duke i hapur derën edhe të akuzuarit tjetër, e po ashtu, disa herë edhe duke u larguar me armë në dorë nga automjeti e në drejtim të vendit të ngjarjes, - pra, ku janë vrarë tani tre të ndjerët, ndërsa, nga deklaratat e dëshmitarit Naser Leci, por edhe deklaratat e dëshmitarit tjetër F.Th., rezultojnë se me armë zjarri është qëlluar edhe nga brendësia e automjetit ku ka qëndruar i akuzuari E.Sh.2, kurse gjykata e shkallës së parë, vetëm në mënyrë të përgjithësuar ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit E.Sh.2, plotësohen të gjitha elementet e veprës penale dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 1 e lidhur me par. 2 nën par. 1 të KPK-së, mirëpo, pa konstatuar se veprimet inkriminuese të akuzuarit që rezultojnë nga provat e cekura më lartë se në cilën fazë të kryerjes së veprës penale të vrasjes nga i akuzuari E.Sh., janë ndërmarrë nga ana e të akuzuarit E.Sh.2, e që pastaj, të mund të konstatohet se a kemi të bëjmë me vepër penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.11 të KPK-së, apo vepër penale dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 1 e lidhur me par. 2 nën par. 1 të KPK-së.

Përfundimisht, gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe nga neni 361 të KPPK-së, ngase, në bazë të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, rezultojnë se të akuzuarit E.Sh. dhe E.Sh.2, kanë deklaruar që dëshirojnë të mbrohen në heshtje, që do të thotë se të njëjtit nuk janë deklaruar fare në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ndërsa, gjykata e shkallës së parë, tërë arsyetimin e sajë e bazon në deklaratat e të akuzuarve të dhëna në fazat e mëhershme të procedurës paraprake, mirëpo, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor nuk rezultojnë të jenë të proceduara deklaratat në fjalë, prandaj, rezultojnë se aktgjykimi i ankimuar mbështetet edhe në prova që nuk janë proceduar fare në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjë që bie ndesh drejtë për së drejti me dispozitat e nenit 361 të KPPK-së.

Duke pasur parasysh të cekurat si më lartë, qëndrojnë pretendimet ankimore edhe në kuptim të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të shkeljes së ligjit penal në dëm të akuzuarve, gjegjësisht, në favor të akuzuarit E.Sh.2, kuptohet sipas prokurorisë, ngase, pa eliminimin e shkeljeve në fjalë nuk mund të flitet as për vërtetimin e plotë e të gjendjes faktike e as aplikimit të drejtë të ligjit penal, për çka edhe kjo gjykatë vendosi që çështja në fjalë të anulohet dhe të kthehet në rigjykim.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë, duhet të veprojë në pajtim me vërejtjet e lartë cekura, t'i eliminojë kundërthëniet e cekura, t'i procedojë edhe njëherë të gjitha provat për zbardhjen e drejtë dhe të plotë të fakteve, pastaj, të marrë për bazë deklaratat e të akuzuarve gjithashtu, të ketë parasysh që me qëllim të eliminimit të kundërthënies në fjalë të bëhet edhe rikonstruimi i vendit të ngjarjes, krejt këto me qëllim të vërtetimit se a veproi i akuzuari në ndikimin e afektit mendor, pastaj, të eliminohen kundërthëniet në mes të ekspertizave të psikiatrisë qoftë edhe përmes super

ekspertize, të merren parasysh edhe faktet dhe rrethanat që rezultojnë nga provat materiale si CD-e, foto dokumentacioni dhe skica e vendit të ngjarjes, pastaj, faktet dhe rrethanat që deklarojnë dëshmitarët Naser Leci dhe F.Th., sidomos për të akuzuarin E.Sh.2 dhe pas procedimit të provave duhet që të njëjtat t'i vlerësojë në pajtim me dispozitën e nenit 361 të KPPK-së, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave duhet të nxirren konkluzionet të drejta dhe të ligjshme e që kanë mbështetje në prova të proceduara, e pastaj, të merret vendimi përkatës, i ligjshëm, duke i pasur parasysh edhe pretendimet tjera të cekura në ankesë.

Meqenëse, aktgjykimi i shkallës së parë, është anuluar përkitazi me veprat penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.11 të KPK-së, dhe dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 1 e lidhur me par. 2 nën par. 1 të KPK-së, ankesat e të dëmtuarve përkitazi me vendimin për dënim për këto vepra penale, tani për tani janë jo lëndore.

Për të akuzuarin E.Sh. duke pasur parasysh se edhe më tutje qëndrojnë bazat ligjore për paraburgim konform dispozitave të nenit 187 të KPPK-së, Gjykata e Apelit, bazuar në dispozitat e nenit 402 par. 4 të KPPK-së, ka vazhduar paraburgimin.

Nga çka u tha më lartë, e konformë dispozitës së nenit 402 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.58/2018, më 06.03.2018

**Procesmbajtëse,
Syzana Goxhuli**

Anëtarët e kolegjit,

1.Xhevdet Abazi

2. Afrim Shala

**Kryetari i kolegjit,
Abdullah Ahmeti**